



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.122 dt.26.10.2001

**PER  
KALIM NE FOND BANESE DHE PER PAJISJE ME AUTORIZIM DEFINITIV  
PER BODRUMET E PAPERIVATIZUARA**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të dt.26.10.2001 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Për kalimin në fond banese dhe për pajisje me autorizim definitiv për bodrumet e paprivatizuara”, mbështetur në Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, pika e, VKM-së Nr.49 dt.29.01.1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.9 dt.25.11.1992 “Për marrjen e bodrumeve dhe lirimin e sipërfaqeve të tepërta të banimit”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.43 dt.09.05.1995 “Për kalimin në fond banese për bodrumet”, si dhe Dekretit të Presidentit të Republikës Nr.1440 dt.04.04.1996 “Për privatizimin e banesave shtetërore të paprivatizuara

**V E N D O S I**

1. Të kalojë në fond banese bodrumet në adresat e mëposhtme dhe të bëhet pajisja me autorizim definitiv për qytetarët sipas strukturës përkatëse:

- 1.Mukades Manka – për bodrumin (1+1) në adresën Rr.Durrësit, Pll.85, shk.2
- 2.Shpëtim Pasha – për bodrumin (1+1) në adresën Rr.Durrësit, Pll.85, shk.1

3Qazim Peqini – për bodrumin (1+1) në Adresën Rr.V.Pasha, Pll.2,  
shk.2

2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore për të zbatuar këtë vendim
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**



